



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Olti Trasing” Sh.P.K. të datës 23.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 18.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria Ritender” me nr. të prokurimit 616-24-219-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **HEDHET POSHTË si e pasafatshme** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Olti Trasing” Sh.P.K. e datës 23.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 18.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria Ritender” me nr. të prokurimit 616-24-219-5-1-1.
- II. **VËRTETOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 18.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Olti Trasing” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Olti Trasing” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 23.04.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 18.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria Ritender” me nr. të prokurimit 616-24-219-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 nënparagrafin c) të RRPP.

Parashtruesi e ka ngarkuar kërkesën për rishqyrtim me datë 23.04.2024 në ora 16:11 ndërsa njoftimi mbi vendimin i AK është publikuar me datë 18.04.02.2024. Përmes nenit 60 par. 60.1 nënpar. c) të RRPP është përcaktuar se *“Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin e AK për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) për anulim të procedurës së prokurimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK është dita (0)”*.

Në rastin konkret dita e njoftimit mbi vendimin është 18.04.2024 dhe kjo ditë kalkulohet dita zero. Ndërsa afati për të parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër këtij vendimi ka qenë pesë ditë pas kësaj date që nënkupton deri me datën 23.04.2024 në ora 16:00. Në anën tjetër kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është dorëzuar me datë 23.04.2024 në ora 16:11 që nënkupton se është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 nënparagrafin c) të RRPP.

Në këtë mënyrë është gjetur se kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është e pasafatshme. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është hedhur poshtë si e palejuar.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 60 par. 60.1. nënparagrafin c) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 25.04.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.